



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9310/2019
Data: 10.10.2019

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e nëntë -IX- për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 17.09.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Përfaqësuesi i OSB-së . Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i buxhetit të komunës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2021-2022.
3. Shqyrtimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.
4. Shqyrtimi i propozim ndryshimeve për rregulloren për transparencë.
5. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuar.
6. Shqyrtimi i propozim vendimit për caktimin e kritereve dhe shpalljen e konkursit për komitetin konsultativ për personat me aftësi të kufizuar.
7. Shqyrtimi i raportit të performancës për vitin 2018.
8. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2019/2020
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

MIRATOHET RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i buxhetit të komunës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2021-2022.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020 është në shumë prej 2,742,095 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2021 janë në shumë prej 2,846,397 € dhe për vitin 2022 janë në shumë prej 2,958,963 €. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2020 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: paga dhe mëditje 1,687,983 €, mallra dhe shërbime 303,236 €, shpenzime komunale 60,000 €, subvencione dhe transfere 61,104 € dhe shpenzime kapitale 629,772 €. Buxheti është përgatitur në konsultim me të gjitha drejtore të dhe janë mbajtur diskutimet publike. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- te investimet kapitale për vitin 2020 vërehen që nga vitet e kaluara janë përcjellë për vitin 2020 dhe a ka ndonjë projekt që është kryer dhe mos me shënuar në tabelë për shkak se gati e njëjta është duke filluar prej rregullimit të kanalizimeve , shtrimi me kubëza betoni për të njëjtat rajone dhe nëse ka projekte që janë kryer është mirë mos me i shënuar në tabelë për shkak se çdo herë po figuron e njëjta. Në buxhetin e vitit 2020 ishte planifikuar shtimi i kapacitetit të ujit në shumë prej 5000 € të planifikuara. Kjo shumë a është planifikuar që me pasur ndonjë donacion nga jashtë apo keni ndonjë planifikim tjetër.

Rufki Suma thekson:- ndoshta vërehen se janë projekte të njëjta por rregullime të kanalizimeve do të kemi çdo herë për shkak se bëhen ndërtime të reja. Me një kod planifikohen me qëllim që mos me shënuar emrat e fshatrave por në ato fshatra që janë nevojat më të mëdha investojmë. Te projekti i çështjes së ujit e kemi lënë si kod. Jemi në biseda me shoqatën "Islamic Relief" të cilët kanë premtuar që do të bëjnë shpime dhe hulumtime të ujit.

Mehmet Ballazhi thekson:- riparimet nuk besoj që hyjnë te investimet kapitale për shkak se investim kapital është diçka tjetër dhe renovim është diçka tjetër dhe si investim kapital nuk besoj që ia kishte vlejtur në këtë formë me shënuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

U VOTUA BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2020 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2021 -2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020 gati se është i njëjtë me vitin e kaluar. Janë planifikuar të mbahen dymbëdhjetë mbledhje për vitin 2020. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

U VOTUA PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Shqyrtimi i propozim ndryshimeve për rregulloren për transparencë.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

U VOTUA PROPOZIM NDRYSHIMI PËR RREGULLOREN PËR TRANSPARENCE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Shqyrtimi i propozim vendimit për caktimin e kritereve dhe shpalljen e konkursit për komitetin konsultativ për personat me aftësi të kufizuar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR CAKTIMIN E KRITEREVE DHE SHPALLJEN E KONKURSIT PËR KOMITETIN KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Shqyrtimi i raportit të performancës për vitin 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

U VOTUA RAPORTI I PERFORMANCES PËR VITIN 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2019/2020

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- diçka konkrete nuk kam me shtuar sa i përket informatës por në fund e kam shënuar që kërkoj ndihmën e ekzekutivit dhe legjislativit që të më ndihmojnë për çështjen e paraleles së ndarë në fshatin Seçishtë dhe në fshatin Krivenik. Në këtë vit e kam ndarë tabelarin për shkollën fillore “Ilaz Thaçi” në mënyrë që të dihet se sa nxënës i kemi në Seçishtë dhe në fshatin Krivenik. Në fshatin Krivenik i kemi vetëm dhjetë nxënës në klasën e dytë, tretë dhe të katërt për shkak se në klasën e parë nuk ka të regjistruar edhe pse ka qenë një po me vetë dëshirën e prindërit ka kërkuar që të regjistrohet në vitin e ardhshëm, e që është keç me ia humbur një vit fëmijës pse nuk ka shokë. Vitin e kaluar dhe në këtë vit e kam shënuar që me biseduar me prindërit në mënyrë që me i bindur që duhet të transportohen nxënësit në Han të Elezit për arsy se nuk ka mësim. E njëjtë situatë është edhe në fshatin Seçishtë që janë 38 nxënës dhe vetëm klasa e dytë i ka dhjetë nxënës tjerat më pak, e që me ligj është që nën 14 nxënës nuk formohet klasa. Realisht me më pyetur mua mendoj që duhet të barten nxënësit e fshatit Seçishtë dhe të fshatit Krivenik. Unë jam interesuar për numrin e nxënësve të Lagjes së Re që në klasën e parë janë njëmbëdhjetë nxënës, në klasën e dytë janë vetëm katër nxënës, në klasën e tretë janë tetë nxënës, në klasën e katërt janë pesë nxënës dhe në klasën e pestë janë shtatë nxënës. Është e ndaluar me ligj investimi në ato shkolla që i kanë nën 100 nxënës sepse Bashkimi Evropian ka pasur me investuar në shkollën e Krivenikut por kanë potencuar që nuk do të investojnë.

Mehmet Ballazhi thekson:- politikat e arsimit nuk janë planifikuar në nivel të përgjithshëm mirë për shkak se nuk është bërë një projekt afatgjatë i çështjes që mund ta zgjidhë këtë problem përgjithmonë. Nuk është problem i madh për mi bartur nxënësit e fshatit Seçishtë dhe të Krivenikut por problem është mbingarkesa për shkak se në këtë vit janë dy apo tri klasë të cilat i kanë nga 35 nxënës që është tepër ngarkesë, mirëpo ka paralele që nuk ka edhe vend ku me u ulë dhe është problem mësimin me mbajtur. Këto politika duhet të zhvillohen në aspektin arsimorë që kanë profesionalizëm në këtë drejtim e jo vetëm me potencuar që po bëjmë politikë arsimore e mos me ditur se çka jemi duke bërë por me gjetur një zgjidhje të përhershme siç ishte ideja për ndërtimin e një shkolle në Lagje të Re. Duhet të ketë një unitet më të madh i gjitha forcave me bërë një zgjidhje të përhershme për ndryshe gjithë kemi me pasur probleme. Ka mungesë të librave të gjuhës Gjermane në shkollë edhe është mirë me iu bërë presion për me i sjellur. Për çështjen e bartjes së nxënësve ju mund të formoni komisioni për shkak se më shumë është çështje që ju duhet me zgjidhur si komunë dhe jepni idetë e mendimit, e në kuvend secili ka ide dhe mendim dhe mund të vihet deri te një zgjidhje. A ka ndonjë lëvizje rreth funksionimit të çerdhes?

Menduh Vlashi thekson:- për çështje të çerdhes ministria nuk ka lejuar shtimin e punëtorëve. Për me përmirësuar cilësinë në arsim duhet të ndërtohet një shkollë ashtu siç potencojojë para folësi por është problem çështja e pronësisë ose duhet të shtohen tetë apo nëntë klasë këtu sepse i kanë të gjitha kushtet për mësim dhe mësimi mund të zhvillohet vetëm me një ndërrim

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

U VOTUA INFORMATA MBI FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLOR 2019/2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- cila është mundësia me i bërë zgjidhje çështjes së furnizimit me ujë në fshatin Gorancë për shkak të borxhit të cilin e kishin për pompat e ujit. A ka ndonjë mundësi si ekzekutiv me i bërë zgjidhje pasi që e kanë ujin?

Rufki Suma thekson:- ne kemi biseduar që banorët me u kyçur me kompaninë "Bifurkacioni" në mënyrë që me u bërë zgjidhje por banorët nuk kanë pranuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:50

Procesmbajtësi

Aymil Bushi

